



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0747
Data e Vendimit: 05.10.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 dhe nenit 64 të Rregullores Nr.002/2022 për Prokurim Publik pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik SELMANS NETWORK SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-23-7702-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal - Rahovec, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën: 05/10/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e "SELMANS NETWORK" SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/0747, e datës 29/09/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE – Ritenderim”, me numër të prokurimit 623-23-7702-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal - Rahovec.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Kuvendi Komunal - Rahovec që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE – Ritenderim”, me numër të prokurimit 623-23-7702-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Kuvendi Komunal Rahovec në cilësinë e Autoriteti Kontraktues me 24.07.2023 ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë ndërsa me datën 13.09.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE – Ritenderim”, me numër të prokurimit 623-23-7702-5-2-1.

Me datë 18.09.2023 OE SELMANS NETWORK SH.P.K kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 19.09.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të pa bazuar.

Operatori ekonomik i pakënaqur me vendimin e AK - Kuvendi Komunal Rahovec, ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit përmes sistemit e-prokurimit me datën 29.09.2023 ora 23:38.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-23-7702-5-2-1, në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK) Kuvendi Komunal - Rahovec, ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë 13.09.2023. Ndaj këtij njoftimi është paraqitur kërkesë për rishqyrtim nga operatori ekonomik ankues me datën 18.09.2023 ndërsa me datën 19.09.2023 AK ka refuzuar kërkesë për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Meqenëse AK - Kuvendi Komunal Rahovec, me datën 19.09.2023 AK ka refuzuar kërkesë për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues, afati ligjor për të paraqitur ankesë në OSHP ka filluar të rrjedh nga data 20.09.2023 deri me datën 29.09.2023 ora 16:00.

Zyra për pranimin e ankesave pas pranimit të ankesës ka konstatuar se operatori ekonomik ankues SELMANS NETWORK SH.P.K. ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 29.09.2023 ora 23:38, qe rrjedhimisht i bie jashtë afatit ligjor të paraparë me dispozitat ligjore.

OE ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 2 të nenit 109 të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtror ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK.

Neni 109 paragrafi 2 i LPP-së përcakton se *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.*

Po ashtu, edhe neni 64.1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për*

zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së. Si dhe neni 5 i LPP-së përcakton se “afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.”

Bazuar në dispozitën e lartcekur, Operatori ekonomik ankues ka parashtruar ankesën në OSHP me datë 29.09.2023 ora 23:38 dhe si rrjedhojë afati i fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë 29.09.2023 ora 16:00.

Zyra e pranimit të ankesave, gjatë verifikimit nëse ankesa edhe e dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, po ashtu nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

-Përfundimi-

Mbi bazën e të lartcekurave konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 29.09.2023 ora 23:38 nga OE SELMANS NETWORK SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit me titull: “NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-23-7702-5-2-1, është e jashtafatshme sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesën brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues si dhe nuk ka ofruar dëshminë e pagesës me rastin e parashtrimin të ankesës në OSHP. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 109 dhe nenin 64 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik si dhe pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së të Ligjit për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP, po ashtu Ankuesi nuk ka paguar fare tarifën lidhur me këtë ankesë.

AK mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit (i përshkruar si me sipër), nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - SELMANS NETWORK SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: